

Date 19/03/2024

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“ K Studio Construction & Development“ SHPK

Neni 1

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe në përputhje me dispozitat e statutit të saj.

Neni 2

Emërtimi i Shoqërisë është “ **K Studio Construction & Development**“ SH.P.K.

Ortaku i vetem i shoqërisë është:

Z. Klajdi Kallmeti, atësia Altin, amësia Rudina, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në KRUIJË, lindur më 14/01/2001, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me ID nr. 035872715 dhe nr. personal K10114007C

Neni 3

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën; Rruga “Kristo Luarasi”, Pallati Gener 2, Struktura A, Apartamenti 03, Tirane

Neni 4

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Objekt kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është studio arkitekture.

Gjithashtu: Investime, pjesmarrje në fushën industriale turistike, në fushën agroturizëm, duke përfshirë të gjitha operacionet komerciale, ndërtimore, industriale së bashku me shërbimet përkatëse që konsistojnë në investimin, sipërmarrjen, realizimin, blerjen, shëndërrimin, kompensimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndërtimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, shërbimeve përkatëse specifike në konceptimin, krijimin, realizimin dhe zhvillimin e aktivitetit hotelier-turistik, tregtimin e mallrave të ndryshme me shumicë dhe pakicë, veprimtari në fushën e shit-blejes si dhe të gjithë formave të qirasë apo të shfrytëzimit të pasurive të patundshme. Veprimtari në fushën e strukturave akomoduese hotelieri, bar restorant, me plan shërbim të personalizuar dhe plan shërbim “ cdo gjë e përfshirë” (all inclusive), shazllone, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, pistë në det me lokacion bar restorant, vendbazim për mjete ujore, motorrike dhe jo motorrike, transport organizim i tureve guidave të ndryshme turistike, zhvillimi i panairëve, shërbime opsionale plotësuese me karakter ç’lodhje, pushimi, apo dëfrimi, spektakli, lojëra, organizime dhe realizime “event-sh” të ndryshme, shërbimi spa, shërbim parkimi, si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për vijimin e aktivitetit.

Projektme dhe studime urbanistike: projektme e ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore: studime ambjentalistë dhe vleresim të ndikimit në Mjedis: projektme interieresh: projektme të inxhinierise elektrike, si dhe konsulenca për temat e mësipërme. Mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim, konsulencë teknike për punime apo projektë të ndryshme në

ndërtim, shërbime oponente për punime apo projekte të ndryshme në ndërtim etj. Te zhvilloj aktivitet ne fushen e studim projektim, supervision dhe ndertim.

Transport per vete dhe te trete.

Hapja e pikave te servisit, parkime, bar restorante, hoteleri, agjenci turistike e komisionere, si dhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje të drejteperdrejte apo të terthorte me aktivitetet e lartpermendura dhe që shërbejnë për permbushjen e objektit të veprimtarisë.

Neni 5

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një afat të pakufizuar kohe.

Neni 6

Ortak i vetëm i shoqërisë është: **Z. Klajdi Kallmeti**, që zotëron 1 (një) kuote, pra 100 (njqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Administrimi i Shoqërisë do të realizohet nga administrator **Z. Klajdi Kallmeti**.

Administrator e shoqërisë zgjidhet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizzjedhje.

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 (një milion) Lek, kapital i ndarë në 1 (një) kuote, pra Pjesëmarrja në përqindje 100 % (njqind perqind).

Neni 9

Ky Akt Themelimi u hartua në tre kopje origjinale, në gjuhën shqipe duke pasur të gjitha fuqi të barabartë ligjore.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE " K STUDIO CONSTRUCTION & DEVELOPMENT" SH.P.K

KLAJDI KALLMETI

